



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorazuar Primen / Predato Received / Delivered	20 . 11 . 8	viti god year
Organ / Mjesie Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix
SKAMSHCK	6975/2018	111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 280 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Ferizajt, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Ferizajt.
2. Obligohet Kryetari i Komunës së Ferizajt për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Ferizajt është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Ferizajt dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit

Faqe 1 / 1





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimjen / Prodato Received / Delivery		20 . 11 2018		8	vit god year
Organ / Njese Org. n / Jednica Org. unit	Nr Prot. Br Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SPAMSHCK	6975/2018		1114		

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

KOMUNËN E FERIZAJT

Prishtinë, maj 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Komunën e Ferizajt.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	9
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	9
Procedurat Disiplinore.....	10
Procedurat e Ankesave.....	11
Procedurat e Vlerësimit.....	12
Procedurat e Pushimeve.....	12
Procedurat e Transferimit.....	12
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	13
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	13
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	13
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civilë është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	13
Trajnimi i Nëpunësve Civilë.....	14
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	14
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	14
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	14

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Nr.02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektivat e mbikëqyrjes kanë për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementimit të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit për shërbimin civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë fushat si në vijim:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civilë është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civilë;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË KOMUNËN E FERIZAJT

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Ferizajt, për të vlerësuar drejtë, në mënyrë të pa anshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Komuna e Ferizajt, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Komunën e Ferizajt, me datë 06.04.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marrë një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Konkursi i datës 12.09.2017, për pozitën „Zyrtar për Bibliotekë 4”
- Konkursi i datës 27.10.2017, për pozitën „Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme”
- Konkursi i datës 01.11.2017, për pozitën „Asistente Administrative”
- Autorizimi i datës 17.01.2017, i Ministrisë së Administratës Publike/Departamenti për Administrimin e Shërbimit civil për pozitën „Zyrtar për Shërbime Sociale”
- Autorizimi i datës 22.12.2016, i Ministrisë së Administratës Publike/ Departamenti për Administrimin e Shërbimit civil për pozitën „Zyrtar për Shërbime Sociale”
- Autorizimi i datës 22.12.2016, i Ministrisë së Administratës Publike/ Departamenti për Administrimin e Shërbimit civil për pozitën „Zyrtar Ligjor 2”
- Autorizimi i datës 07.08.2017, i Ministrisë së Administratës Publike/ Departamenti për Administrimin e Shërbimit civil për pozitën „Zyrtar për Arkiv 4”
- Autorizimi i datës 13.10.2017, i Ministrisë së Administratës Publike/ Departamenti për Administrimin e Shërbimit civil për pozitën „Zyrtar për vlerësimin e pronës së paluajtshme”
- Te dhënat për të punësuarit në Shërbimin civil për Komunën e Ferizajt
- Njoftim për zgjatjen e afatit i datës 31.10.2017 lidhur me konkursin përkatës
- Konkursi i datës 23.02.2017, për marrëveshje shërbime të veçanta, për pozitën “Zyrtar Administrativ”
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-111-17424
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-111-17514
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-111-17835
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-111-17735
- Konkursi i datës 18.08.2017, me numër protokolli Nr. 01-312/17, për pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile”.
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-102/02-00881/17
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-102/02-0087732/17
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-102/02-00889325/17
- Konkursi i datës 07.04.2017, me numër protokolli 121/17, për marrëveshje shërbime të veçanta, për pozitën Zyrtar Administrativ në “Qendrën për pune Sociale”.
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.01.2017, me numër protokolli Nr. 02-111-4519
- Vendim për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil i datës 14.04.2017

- Vendim për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil i datës 20.03.2017
- Vendim për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil i datës 17.03.2017
- Vendimi për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil i datës 10.01.2018
- Vendimi për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil i datës 01.06.2017
- Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 11.01.2018, me numër protokollit 01 Nr. 18/18
- Formulari për vlerësimin e punës për pozitën “Zyrtar Ligjor”
- Vendim për pushim pa pagesë i datës 13.02.2017
- Vendim për pushim pa pagesë i datës 25.05.2017
- Vendim për pushim mjekësor pa pagesë i datës 30.06.2017
- Vendim për pushim pa pagesë i datës 01.06.2017
- Vendim për pushim të lehonisë i datës 29.03.2017
- Vendim për pushim të lehonisë i datës 22.06.2017
- Vendim për pushim të lehonisë i datës 06.06.2017
- Formulari për mbledhës për nëpunësit civilë të vlerësuar me nota
- Vendimi i datës 09.01.2018 me nr. protokollit 02-102/02-0129029/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 09.01.2018 me nr. protokollit 02-102/020128101/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 09.01.2018 me nr protokollit 02/-0129214/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 09.01.2018 me nr protokollit 02/-0128898/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 09.01.2018 me nr protokollit 02/-0129097/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 05.01.2018 me nr protokollit 02/-0126589/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 09.01.2018 me nr protokollit 02/-0121856/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 09.01.2018 me nr protokollit 02/-0121856/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 28.06.2017 me numër protokollit 02/-0058983/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 05.01.2018 me Nr protokollit 02-102/02-0124791/17 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 05.01.2018 me numër protokollit 02-102/02-012918/17 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 05.01.2018 me Nr protokollit 02-102/02-0128366/17 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 05.01.2018 me Nr protokollit 02-102/02-0128023/17 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Dëshmi për pensionim për vitin 2017, për nëpunësit civilë
- Organogrami i Komunës së Ferizajt
- Vendimi i datës 30.10.2015, me numër protokollit 01 Nr. 295/15 për caktimin e kryesuesit të detyrës „Udhëheqës i Zyrës Ligjore”
- Formuari i planit Individual të Personelit
- Vendimi i datës 03.02.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Raif Kashtanjeva
- Kërkesa për pagesë retroaktive 09.02.2017

- Vendimi i datës 04.10.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Ramadan Nuhiu
- Vendimi i datës 30.08.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile Mahire Jashari
- Kërkesa për pagesë retroaktive 08.09.2017
- Vendimi i datës 08.04.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Nehat Hoxha
- Kërkesa për pagesën retroaktive e datës 07.04.2017
- Vendimi i datës 01.01.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile Ajshe Kurti
- Kërkesa për pagesë retroaktive e datës 08.11.2017
- Vendimi i datës 21.12.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Hysen Ajvazi
- Kërkesa për pagesë retroaktive e datës 08.01.2018
- Vendimi i datës 25.01.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Ramiz Lushi
- Kërkesë për pagesë retroaktive e datës 09.02.2017
- Vendimi i datës 10.01.2017, për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile Emine Bunjaku
- kërkesa për pagesën retroaktive e datës 09.02.2017
- Vendimi i datës 01.02.2017, për pezullimin parandalues për nëpunësin civil Muhamet Kalenica
- Vendimi i datës 12.02.2018, për themelimin e Komisionit Disiplinor
- Vendimi i datës 23.05.2015, për themelimin e Komisionit Disiplinor
- Vendimi i datës 26.12.2017, për Themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 06.01.2017, për Themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave
- Vendimi i datës 20.02.2017, për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës
- Konkursi i datës 04.08.2016
- Akt Emërimi i datës 31.03.2017
- Kërkesa për punësim e z, Amir Strublla, me shkresat e bashkangjitura
- Kërkesa për punësim e znj, Lendita Selimi, me shkresat e bashkangjitura
- Raporti Final i rekrutimit nga Komisioni Rekrutues
- Regjistrimi i aplikacioneve të pranuar për pozitën „Zyrtar Ligjor”
- Njoftimi i datës 21.02.2017, për rezultatet e testimit me shkrim
- Përmbledhja e vlerësimeve individuale
- Renditja përfundimtare e kandidatëve
- Finalizimi i listës së Ngushtë
- Njoftimi i kandidatit të suksesshëm i datës 21.02.2017
- Kërkesa për punësim e znj, Gjyzide Haziri, me shkresat e bashkangjitura
- Testimi me shkrim për pozitën „Zyrtar Ligjor”
- Kërkesa për punësim e znj, Bukuri Jahiu, me shkresat e bashkangjitura
- Kërkesa për punësim e z, Alban Idrizi, me shkresat e bashkangjitura
- Kërkesa për punësim e znj, Habibe Salihu, me shkresat e bashkangjitura
- Evidenca e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, për të gjitha Shkollat e Komunës së Ferizajt

- Kërkesë e datës 22.12.2017, për pezullimin e të gjitha vendimeve dhe akt emërimeve, rekomandimeve, kontratave të nënshkruara pas datës 20.11.2017, nga ish kryetari i Komunës së Ferizajt
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë, për pozitën „Zyrtar i Njesisë për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit”
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë, për pozitën „Zyrtar i Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve”
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Gjon Serreçi”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Jeronim de Rada”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Tefik Çanga”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Ahmet Hoxha”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Ganimete Tërbeshi”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Besim Rexhepi”, në Komogllavë
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Bilall Shala”, në Lloshkobare
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Konstandin Kristoforidhi”, në Neredime
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Naim Frashëri”, në Zaskok
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Dituria”, në Dardani
- Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë të Muzikës “Çesk Zadeja”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Abetarja”, në Softaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Visar Dodani”, në Varosh
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Ismajl Qemaili”, në Prelez i Jerlive
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Liman Rekaj”, në Prelez i Muhaxhëreve
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Ramadan Rexhepi”, në Sojëve
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Ali Hadri”, në Mirash
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Arsim Rexhepi”, në Sazli
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Halit Ibishi”, në Cërnillë
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Dardania”, në Rakaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “pa emër”, në Tërre
- Drejtor i Shkollës së Mesme Teknike “Pjetër Bogdani”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Dëshmoret e Lirisë”, në Manastricë
- Drejtor i Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike “Faik Konica”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Skënderbeu”, në Jezerc
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Enver Topalli”, në Greme
- Drejtor i Shkollës së Mesme “Faik Konica”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Gjon Serreçi”, në Ferizaj
- Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ulët “Gjon Serreçi”, në Ferizaj
- Drejtor i Gjimnazit “Kuvendi i Arbërit”, në Ferizaj

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në komunën e Ferizajt më datë 06.04.2018, ka konstatuar që ky institucion nuk ka në fuqi Rregulloren për Organizim e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Ferizajt. Në këtë institucion janë të lejuar me buxhet (301) nëpunës civilë, dhjetë (10) pozita janë të lira.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Ferizajt nuk ka të miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Ferizajt.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt që të ndërmarrë të gjitha veprimet për hartimin dhe miratimin Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Ferizajt, ashtu si e përcaktojnë dispozita ligjore në fuqi të Rregullore nr. 09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Shtetërore.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civilë, mirëpo si kopje ka marrë tri (3) dosje dhe atë për pozitën „Gjeometër”, „Asistente Administrative” dhe „Zyrtar i Qendrës Komunale të Vlerësimit”. Kolegji ka konstatuar se dosjet janë në pajtim me dispozitat e Rregullore Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Ushtuesit e detyrës: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Ferizajt, për vitin 2017, nuk ka pasur pozita me ushtues detyre, sipas dëshmimeve të marra në këtë Komunë dhe deklarimit të Menaxheres së Personelit.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Ferizajt, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar gjithsej katërmëdhjetë (14) procedura të rekrutimit në administratën e Komunës së Ferizajt Nga ky numër 4 procedura janë anuluar nga ana e KPMSHC pas ankesave të bëra nga ana e palëve, por në këtë numër nuk janë të përfshirë procedurat e rekrutimit për Drejtor dhe Zv.drejtor të shkollave në Komunën e Ferizajt. Për pozitat që nuk përfshihen shkollat kemi marrë si mostër këto procedura: “Asistente Administrative”, “Zyrtar i Gjendjes Civile”, “Zyrtar Ligjor”, “Zyrtar për Mirëqenie Sociale”, “Inspektor i Tregut”, “Zyrtar për Arkivë”, “Zyrtar i Tatimit në Pronë”, “Përkthyes Shqip-Serbisht dhe Anasjelltas”, “Zyrtar për Vlerësimin e Pronës”, ndërsa për pozitat e Drejtorëve dhe Zv.drejtorëve Komuna e Ferizajt ka shpallur gjithsej 31 pozita.

E GJETURA 1. Kolegji i Këshillit gjatë monitorimit të dosjeve të rekrutimit të lartshënuara, ka konstatuar se Komuna e Ferizajt për 4 procedura të rekrutimit ka bërë zhvillimin e procedurave në

kundërshtim me Ligjin nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit, sepse ka vepruar në kundërshtim me nenin 11, 12 dhe 18 të ligjit të lartshënuar.

REKOMANDIM 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt, që me rastin e shpalljes së pozitave të lira për rekrutim në shërbimin civil të Kosovës të veprojë në pajtim me nenin 11, 12 dhe 18 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren 02/2010 për Rekrutimin në Shërbimin Civil të Kosovës.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të nëpunësve civilë ka konstatuar se në Komunën e Ferizajt, me rastin e publikimit të konkurseve për Drejtor dhe Zëvendës Drejtor, nuk është bërë kërkesë për autorizimin e shpalljes së konkursit tek Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Administrimin e Shërbimin Civil, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

REKOMANDIMI 2

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të bëjë **SHFUQIZIMIN** e të gjitha pozitave të rekrutuara për Drejtor të shkollave dhe Zv.drejtor në Komunën e Ferizajt, sepse janë shpallur në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

E GJETURA 3: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Ferizajt ka pasur gjatë vitit 2017, 59 marrëveshje për shërbime të veçanta, Komuna ka zhvilluar procedura të thjeshtëzuara lidhur me marrëveshjet dhe Shërbimet e veçanta, gjithashtu në këtë Komunë ka pasur tejkalime të afateve lidhur me marrëveshjet për shërbime të veçanta, marrëveshjet e shërbimeve të veçanta janë të lidhura për pozita të shërbimit civil në kuadër të Komunës së Ferizajt. Këto marrëveshje janë në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafit 4 Ligji Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Kosovës.

REKOMANDIMI 3:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt që të ndërmarrë të gjitha veprimet që në rastin e publikimit të konkurseve për nëpunësit civilë, për pozitat e jo karrierës, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civilë dhe në raste të mbingarkesave në punë të shpallet konkursi në pajtim me nenin 12, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe 4, paragrafi 3 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Ferizajt, e ka të themeluar Komisionin Disiplinor, me vendim e datës 12.02.2018, me numër protokolli 01.nr.75/18 për Themelimin e Komisionit Disiplinor, ka dy (2) anëtarë të përhershëm me mandat dy vjeçar, ndërsa një (1) anëtar rast pas rasti dhe këtë e ka bërë duke ju

10

Këshilli i

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n.
10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

referuar Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil gjatë vitit 2017, kur është zhvilluar një Procedure disiplinore ndaj nëpunësit civil.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit të datës 12.02.2018, me numër protokolli 01. Nr. 75/18 për Themelimin e Komisionit Disiplinor në Komunën e Ferizajt, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka dy (2) anëtarë të përhershëm me mandat dy vjeçar ndërsa një (1) anëtar rast pas rasti dhe këtë e ka bërë duke ju referuar Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil. Kolegji konstaton se ky veprim është në kundërshtim me nenin 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pasi që të tre anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të jenë me mandat dy (2) vjeçar,

REKOMANDIMI 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt, që të ndërmarrë veprimet ligjore për eliminimin e shkeljeve dhe të bëjë themelimin e Komisionit Disiplinor në pajtim me dispozitat e nenit 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Ferizajt e ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, sipas Vendimit të datës 26.12.2017, ndërsa numri i ankesave sipas deklarimit të Menaxheres së Personelit të Komunës së Ferizajt, është gjithsej pesë dhjetë e një (51) gjatë vitit 2017, prej të cilave në KPMSHC janë paraqitur gjithsej 14 ankesa.

E GJETURA 1 . Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, në pjesën hyrëse të Vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, është përdorur Udhëzimi Administrativ Nr.2003/05 të MAP/ DASHC, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe me nenin 94, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në kundërshtim me nenin 12, të Rregullores Nr. 05/2011, për Procedurat e Zgjidhjes se Kontesteve dhe të Ankesave.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt, respektivisht Kryetarin dhe Anëtarët e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave që në rastin e përdorimit të bazës ligjore për nxjerrjen e vendimit të veprohet, në pajtim me nenin 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në pajtim me nenin 94, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, si dhe me neni 95, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 12, të Rregullores Nr. 05/2011, për Procedurat e Zgjidhjes se Kontesteve dhe të Ankesave, sepse në të kundërtën këto Vendime janë të pa zbatuar, sepse janë në kundërshtim me formë lidhur me bazën ligjore.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën Ferizajt, janë bërë vlerësimet e rezultateve të punës për nëpunësit civil për vitin 2017, dhe se nuk ka asnjë nëpunës civil i cili nuk është vlerësuar.

E GJETURA 1 Kolegji ka marrë si provë Vlerësimin e rezultateve në punë për pozitën „Zyrtar i Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve”, i cili vlerësim është nënshkruar me datën 18.12.2017 nga i vlerësuar por vlerësuesi nuk është nënshkruar, gjithashtu mungon data e vlerësimit e që është në kundërshtim, me nenin 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 respektivisht nenit 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe nenit 10 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që vlerësimi i rezultateve të punës për nëpunësit civil, të kryhet në pajtim me nenin 33, paragrafi 1,2,3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë si dhe të bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat nenit 3, paragrafit 1, nën paragrafit 1.3 dhe nenit 10 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Ferizajt mbahet evidenca e nëpunësve civil në kopje fizike dhe elektronike sa i përket pushimeve. Gjatë vitit 2017, 21 nëpunës Civilë kanë realizuar pushim mjekësor, Komuna e Ferizaj ka pasur katër (4) raste të pushimit pa pagesë dhe pesë (5) pushime të lindjes.

Për këtë fushë nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Komunën e Ferizajt gjatë vitit 2017, ka pasur gjithsejtë katër (4), transferime të nëpunësve civil, prej tyre tri (3) transferime të përkohshme, ndërsa një (1) transferim i përhershëm.

E GJETURA 1 Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të vendimeve lidhur me transferimet e përkohshme dhe të përhershme të nëpunësve civilë, ka konstatuar se vendimet për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm janë bërë në kundërshtim me nenin 7 dhe 8, të Rregullores Nr.06/2010, për Procedurat e Transferimit të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që transferimi i përhershëm dhe i përkohshëm i nëpunësve civilë, të behët në pajtim me nenin 7 dhe 8, të Rregullores Nr.06/2010, për Procedurat e Transferimit të Nëpunësve Civilë.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Ferizajt ka të punësuar treqind e një (301) nëpunës civilë, sa përket strukturës etnike është kjo përbërje: 290 shqiptarë, 1 serb, 1 turk, 2 goranë, 1 rom, ndërsa sa i përket strukturës gjinore në Komunën e Ferizajt janë të punësuar 107 femra, ndërsa 194 janë meshkuj. Komuna e Ferizajt ka 4 nëpunës të punësuar që janë me aftësi të kufizuara.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 301 nëpunësve civilë të punësuar në Komunën e Ferizajt, prej tyre 107 janë femra, ndërsa meshkuj janë 194, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIM 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt, që me rastin e rekrutimit të nëpunësve civilë të ri të ketë parasysh respektimin e dispozitave të Ligjit Nr.05/L -020 për Barazi Gjinore, në mënyrë që trajtimi i gjinive të jetë i barabartë edhe në aspektin e punësimit dhe numri i të punësuarve të jetë proporcionalisht i barabartë.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Ferizajt, nuk ka pasur asnjë rast të pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së Punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të dëshmive të ofruara, ka konstatuar në Komunën e Ferizajt, gjatë vitit 2017 nuk ka pasur asnjë nëpunës civil, i cili i cili në të njëjtën kohë mban ndonjë post publik, i cili bie ndesh me ushtrimin e detyrës së nëpunësit civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVILË ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të dëshmive dhe informatave të ofruara nga udhëheqësi i burimeve njerëzore, ka konstatuar se në ministrinë e Komunës e Ferizajt, nuk ka asnjë nëpunës që është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ose është dënuar me vendim të gjykatës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVILË

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Ferizajt ka të përgatitur planin e trajnimeve, mirëpo në bazë të deklaratimit të Menaxheres së Personelit nuk mbahet evidenca e nëpunësve civilë, të cilët marrin pjesë në trajnimet, më të cilin nënkupton se nuk ka evidence gjatë vitit 2017, se sa nëpunës civilë kanë marrë pjesë në trajnimet.

REKOMANDIM 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Ferizajt që të ndërmarrë të gjitha veprimet për eliminimin e shkeljes dhe të mbajnë evidencat e trajnimeve në përputhje me nenin 5 paragrafi 1.3 nën paragrafi 1.3.2 të Rregullores 03/2011 për Dosjet e Nëpunësve Civilë.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Ferizajt vijimi në punë mbahet në formë elektronike, të gjitha pagat e nëpunësve civil janë në pajtim me Akt Emërimet sipas deklaratimit të Menaxheres së Personelit të Komunës së Ferizajt.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Ferizajt, ka pranuar dhjetë (10) vendime të Këshillit, të gjitha vendimet e KPMSHCK-së Komuna e Ferizajt është monitoruar në vitin 2017, për vitin 2016.

15. SHËNIMET/KOMENTET/ PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit me rastin e mbikëqyrjes së të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes në Komunën e Ferizajt, ka arritur të konstatojë 10 të gjetura dhe ka dhënë 10 rekomandime lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Komunës së Ferizajt, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresojë dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.